



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 28.07.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“HOTEL 2 KATE ME PAPAFIGO DHE PISHINË, ME VENDODHJE NË FUSHË  
OKOL, BASHKIA MALËSI E MADHE

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Z. Gëzim Olaj, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Hotel 2 kate me papafingo dhe pishinë, me vendodhje në Fushë Okol, Bashkia Malësi e Madhe, me subjekt zhvillues Z. Gëzim Olaj.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) miratimit të akteve përkatëse sipas legjislacionit të posaçëm për trashëgiminë kulturore;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Malësi e Madhe.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

